



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 585/23 Data: 02.05.23

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (Gazeta Zyrtare Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr. 05/L-31 (Gazeta Zyrtare Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (Gazeta Zyrtare Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), si dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, (përditësuar me vendimin Ref.932/22), Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 111-të, të mbajtur më 14.04.2023, mori:

V E N D I M

- I. **Aprovohet** kërkesa e Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.) me Nr.Prot.2054/22 të datës 08.12.2022 për rivalidim të programit.
- II. **Validohet** akreditimi ndërkombëtar i Kolegjit RIT Kosovo (A.U.K.) për periudhën tre (3) vjeçare (1 tetor 2023 – 30 shtator 2026) për programin e studimit:
 - *Informatikë dhe Teknologji Informative BSc 252 ECTS*, maksimumi 200 studentë për vit akademik.
- III. Numri i përcaktuar i studentëve sikur në paragrafin II aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- IV. Obligohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) që deri me datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit.
- V. Obligohet Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programit të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KShC.
- VI. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VII. Institucioni i Arsimit të Lartë mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) në afatin ligjor me datë 08.12.2022 ka parashtruar kërkesë me Nr.Prot.2054/22 pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim, për rivalidimin e programit të studimit: Informatikë dhe Teknologji Informative BSc 252 ECTS, me stafin akademik bartës si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	Informatikë dhe Teknologji Informative BSc.252 ECTS. Rivalidim	Kamal Shahrabi Mimoza Polloshka Linda Ziberi Edmond Muhaxheri Charles Border Özcan Asilkan Debabrata Samanta

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KShC), në mbledhjen e 111-të, të mbajtur më 14.04.2023, ka shqyrtuar kërkesën e Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.) dhe arsyet e cekura në kërkesë, vlerësimin, validimin nga agjencia amerikane e akreditimit “*Association of Technology, Management, and Applied Engineering*”.

KShC gjatë vlerësimit të programit është i bazuar në nenin 23 Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, në raportin e vizitës së ekipit të ekspertëve të “*Association of Technology, Management, and Applied Engineering*” realizuar me 21 deri 23 shtator të vitit 2022 dhe në certifikatën e akreditimit të lëshuar nga ATMAE.

Andaj KShC duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, raportin dhe certifikatën e ATMAE, si dhe në kompetencat ligjore vendosi si në dispozitiv në këtë vendim.,

Këshillë juridike: *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.*

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji RIT Kosovo (A.U.K.)
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,



 Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi
 Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë